

Bordi i Fondacionit UNË E DU KOSOVËN

Nita Xhiha

Drejtoreshë dhe Anëtare e Bordit

Bashkëthemeluese dhe drejtoreshë e Fondacionit “ UNË E DU KOSOVËN ” . Znj. Xhiha ka diplomuar në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës dhe ka kryer studimet Master në Menaxhim të Mediave në Universitetin e Luganës, Ticino – Zvicër.

Vllaznim Xhiha

Anëtar i Bordit

Bashkëthemelues i Fondacionit “ UNË E DU KOSOVËN ” dhe ideator i qendrave BONEVET. Z. Xhiha është inxhinier i diplomuar në Universitetin e Cyrihut dhe ndërmarrës i suksesshëm me eksperiencë shumëvjeçare.

Lekë Zherka

Anëtar i Bordit

Z. Zherka është një nga ideatorët dhe drejtuesit e rrjetit BONEVET. Ai ka diplomuar në Universitetin Amerikan në Kosovë (RIT Kosovo) dhe ka përvojë të gjerë në menaxhimin e projekteve. Si drejtues i makerspace-it të parë në Gjakovë, ai hodhi themelet për zhvillimin dhe zgjerimin e qendrave BONEVET në nivel nacional.

Ekipi i meDiell

Nita Xhiha

Themeluese dhe Kryeredaktore

Themeluese dhe kryeredaktore e revistës meDiell. Znj. Xhiha ka diplomuar në Gjuhë dhe Letërsi Angleze (Universiteti i Prishtinës) dhe ka përfunduar studimet Master në Menaxhim të Mediave në Universitetin e Luganës, Ticino.

Sara Kelmendi

Redaktore Përgjegjëse

Gazetare dhe redaktore me mbi 20 vite përvojë në media dhe projekte kulturore. Ka diplomuar në Gjuhë dhe Letërsi Angleze (Universiteti i Prishtinës). E specializuar në menaxhim editorial dhe koordinim të përmbajtjes.

Rina Krasniqi

Redaktore Artistike

Shkrimtare dhe artiste, e diplomuar në Komunikim dhe Politika Publike (RIT Kosovo). Ka mbi 10 vite përvojë në editim, publikim dhe menaxhim të projekteve letrare e artistike. E specializuar në koordinimin dhe vizualizimin e përmbajtjes.